

3. Vendi i zhvillimit të konkurimit: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, zyra e Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse, me adresë: *Autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.* www.dogana.gov.al
4. Ofertat dorëzohen nga të interesuarit/konkurrentët fizikisht, me postë ose dorazi, në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurimit.
5. Afati i fundit kohor për dorëzimin e ofertave konkurruese: 14/04/2021.

BASHKIA KAVAJË

Për dhënien me qira të pasurisë me nr. 57/2 vol. 8 faqe 97 në Z.K. 3101 Qerret, e llojit “pa frut”, me sipërfaqe 15 400 m²”

1. Autoriteti Qiradhënës: Bashkia Kavajë

Adresa: Rruga “Josif Budo”, Ndërtesa Nr. 10,
Email: www.kadastra.bashkiakavaje@gmail.com
Tel: [055245555](tel:055245555)

2. Të dhënat për sipërfaqen: Sipërfaqja prej 15400 m² e pasurisë nr. 57/2, lloji pasurisë PF (pa frut), pasuri e cila është në pronësi të Bashkisë Kavajë, regjistruar në ASHK-në Kavajë në vol. 8 faqe 97 ZK. 3101, me vendodhje në fshatin Qerret.

3. Qëllimi i dhënies me qira: Pasuria objekt i dhënies me qira do të jepet në zbatim të nenit 54/1 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe do të meren parasysh të gjitha kërkesat e Ligjit nr 93/2015 “Për turizmin”, kryesisht në fushën e turizmit për qëllime rekreative, pushimi etj, e cila do të gjenerojë të ardhura dhe do të nxisë punësimin.

4. Afati i dhenies me qira: 20 (njëzet) vjet, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.

5. Vlera dysheme për detyrimin e qirase: 270 000 (*dyqind e shtatëdhjetë mijë*) lekë/ha në një vit kalendarik.

6. Konkurimi për marrjen me qira do të kryhet në ambientet e Bashkisë Kavajë në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak me datë 16.04.2021 në orën 11:00.

7. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si më poshtë:

Niveli i investimit	40 pikë
Niveli i punësimit	30 pikë
Oferta e detyrimit mujor të qirasë	30 pikë

8. Subjektet konkurruese duhet të përcjellin dokumentacionin si më poshtë:

- kërkesë e subjektit për marrjen me qira të pasurisë shtetërore
- planbiznes të hollësishëm për vënien në funksion të objektit ku të përshkruhet qartë plani i punësimit, plani i investimit si dhe treguesit që do të realizohen
- ofertën për vlerën e detyrimit mujor të qirasë
- çertifikatën e regjistrimit dhe çertifikatën historike të regjistrimit të subjektit në QKR
- NUIS-in dhe vërtetimin nga dega e tatimeve se subjekti ka shlyer detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore

- vërtetim nga institucionet përkatëse që subjekti nuk është në ndjekje penale si dhe nuk ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin

Mosparaqitja e njërit prej dokumenteve të mësipërme përbën kusht skualifikues.

9. Dokumentacion duhet të paraqitet në zarf të mbyllur, të nënshkruar nga konkurruesi me mbishkrimin “Ofertë për marrje me qira“, dhe i dorëzohen komisionit të shqyrtimit të ofertave, në orën e hapjes së procedurës së konkurrit.

10. Ofertat dorëzohen nga konkurrenti/ët e interesuar, fizikisht me postë ose dorazi në vendin e përcaktuar për zhvillimin e konkurrit.

11. Data e zhvillimit të konkurrit: në ambientet e Bashkisë Kavajë, në sallën e mbledhjes së Këshillit Bashkiak, me datë 16.04.2021 në orën 11:00.

12. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: datë 16.04.2021, ora 11.00.

BASHKIA MALLAKASTËR **NJOFTIMI FITUESI PËR DHËNIEN MË QIRA**

1. Njoftim fituesi për dhënie me qira të sipërfaqes së fondit pyjor me sipërfaqe 5.72 ha, me nr. pasurie 335/14, ZK. 2160, Vol. 2, Fq. 30 në pronësi të Bashkisë Mallakastër për agropylltari.
2. Autoriteti qiradhenes: Bashkia Mallakaster (NJ.Q.V.), Lgj. “18 Prilli”, Ballsh, Tel +355 313 22 113, email: ballshi@bashkiamallakaster.gov.al,
3. Në mbështetje të Ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet”, dhe Udhëzimit të Ministrisë së Mjedisit nr.1, date 09.06.2016 ”Për rregullat, procedurat e kerkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” dhe legjislacionit të zbatueshëm për pyjet dhe shërbimin pyjor/fondin kullosor, Bashkia Mallakastër më datë 04.03.2021 ora 10⁰⁰, ka zhvilluar procedurën e konkurrit publik Dhënie me qira të ekonomisë Pyjore Povël, fshati Klos, Nj.A. Hekal, në pronësi të Bashkisë Mallakastër me sipërfaqe 5.72 ha, me nr. pasurie 335/14, ZK. 2160, Vol. 2, Fq. 30” për agropylltari
4. Njoftojmë së kanë qënë pjesëmarrës në këtë procedurë këta pjesëmarrës me vlerat përkatëse të ofruara

Subjekti “ADG 2020” shpk Nipt M08227801S

Vlera e ofruar 57 500 (pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekë në vit

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm - Nuk ka ofertues të skualifikuar